



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1057 Prot.

Tiranë, më datë 25.7.2023

VENDIM
Nr. 434, datë 25.07.2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 *“Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”*, neni 38, pika 2, VKM-së Nr. 208, datë 10.04.2019 *“Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”*, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 *“Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”*, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 25.07.2023:

VENDOSI:

1. Të miratojë në parim Projekt - Idenë për projektin *“Prezantimi/ Interpretimi dhe Valorizimi i Amfiteatrit Romak, Forumit Bizantin, Banjave Romake dhe i Shtigjeve Urbane në Zonat Arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit dhe Itinerari i Vizitorëve”*, Monument Kulture i Kategorisë së I-rë, me aplikues *“SON Engineering Construction”* dhe zhvillues **Ministria e Kulturës dhe AADF**;
2. Gjatë procesit të detajimit të projekt idesë, projektuesi të rakordojë hapat me projektin *“Hartimi i Planeve të Konservimit dhe Gërmimeve Arkeologjike të Amfiteatrit Romak, Forumit Bizantin dhe Banjave Romake dhe të Shtigjeve Urbane në Zonat Arkeologjike A dhe B të Qytetit të Durrësit”*;
3. Detajimi i projekt – idesë të shoqërohet me Raportin mbi Vlerësimin për ndikimin në Trashëgiminë Kulturore.
4. Propozimi për implementimin e shkallares në Amfiteatër të detajohet pas përfundimit të realizimit të Fazës së I – rë të gërmimeve arkeologjike.
5. Projekt – idea për strukturën lëvizëse *“People Mover”* të vlerësojë dhe të marrë në konsideratë impaktin minimal vizual në monument dhe në pjesën e nëntokës, në përputhje me Raportin mbi Vlerësimin për ndikimin në Trashëgiminë Kulturore që do të hartohet nga projektuesi.
6. Të gjitha tabelat informuese, orientuese dhe shpjeguese duhet të paraqiten për shqyrtim dhe vendimmarrje pranë KKTKM;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

7. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
8. Ngarkohet Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore për regjistrimin e këtij Vendimi;
9. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankim në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Klesta Qirici

